



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 84 Datë 24.12.2021

Për dhënje "Qytetar Nderi "

Mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015“Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, germa m, me kerkese nga Drejtori i Qendres Kulturore Nr. 3887 prot date 31.11.2021 dhe me relacionin e komisionit te perhershem te keshillit Bashkiak me date 03.12.2021 : **Komisioni I rendit publik, mbrojtjes civile dhe vlersimit të figurave të shquara të qytetit** ;i paraqet Këshillit Bashkiak ne rendin e dites në mbledhjen e rradhës miratimin per dhënje "Qytetar Nderi " per te ndjerin **Z. Zabit Shukri Trupja** . Keshilli ne mbledhjen e tij, datë 24.12.2021 miratoi unanimisht per :

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për dhënje "Qytetar Nderi "Dibrës për të ndjerin **Z. Zabit Shukri Trupja** .
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori I arsimit dhe Kulturës dhe Turizmit .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava



RASHKIA PESHKOPI
Nr. 3007
Mberiti Dt. 03/10/20



KERKESE

Nr. Prot. 63/1

Dt. 25.10.2020

Drejtuar: Keshillit Bashkiak Diber

Duke u nisur nga meritat e padiskutueshme te mesimesdhenjes dhe edukimit te brezit te ri, si dhe kontributit te tij personal, duke filluar nga zonat me te thella te Dibres, e deri ne drejtimin e seksionit te arsimit ne Peshkopi, mendojme:

Qe Z. Zabit Shukri Trupja, ti akordohet tituli qytetar nderi I Dibres.

Nderimi per mesuesit eshte nderim per vete qytetarin Dibrane dhe ate Kombetare.

Shepresojme qe propozimi yne do te meret parasysh nga Keshilli Bashkiak I Bashkise Diber.

Drejtori Qendres Kulturore



BIOGRAFI: ZABIT TRUPJA

Lindi më 02.12.1949 në fshatin Staravec të rrethi Dibër , në një familje të thjeshtë dibrane .Arsimin fillor e kreu në vendlindje ,kurse atë tetëvjeçar në Peshkopi ,ku spikati si nxënës me rezultate dhe me krijimet e tije letrare.Në vitin 1968 kreu shkollën e mesme “Shejnaze Juka” Shkodër ,ku hodhi hapa të sigurt drejt formëzimit të një nxënësi me talent . Mbaroi Institutin e Lartë Pedagogjik , Shkodër në viti 1977 me rezultate të shkëlqyra.

Karriera e Z.Trupja filloi si mësues në shkollën “8-vjeçare Martanesh” në vitin 1967 deri në vitin 1970. Në vitin 1970 punoi si mësues në ciklin e ulët Zimur deri në vitin 1971 . Në vitin 1974 punoi si mësues në shkollën “8-vjeçare Zall-Reç” dhe në shkollën “8-vjeçare Vranjt” deri në vitin 1981 . Punoi si Inspektor Arsimit Dibër në vitin 1981 deri ne vitin 1990 ku la gjurmë për profesionalizmin e tijë. Në vitin 1991 punoi në Institucion “Dega e filmit dhe e librit “ deri në 1992 . Në vitin 1992 iu kthye arsimit ku punoi si mësues në shkollën “8-vjeçare Koben” deri në vitin 1995.Në 1995punoi si Zv.Drejtor në shkollën “8-vjeçare Shimcan”deri në vitin 1997 .Më paspunoi si drejtor në shkollën “8-vjeçare Shimcan” nga viti 1997 deri ne vitin 1998 . Në vitin 1998 u emërua drejtor në shkollën “Nazmi Rushiti” deri në viti 2002 ,gjatë këtij viti punoi edhe si zv/drejtor ne shkollën “Irfan Hajrullai”.Ne vitin 2003 u emërua drejtor ne shkollën e sapo krjuar “Myslym Shehu” në Peshkopi, ku punoi si drejtor deri ne vitin 2006,në 2006 kalon si mësues I lëndës së gjuhës në këtë shkollë.Nje sëmundje e rënde ja mori jetën para kohe një njeriu që I kishte dhënë shumë arsimit në nje karrier të gjatë ku kishte lënë gjurmë për përkushtimin dhe mardhënien e shkëlqyer me koleget,por kishte akoma shumë për ti dhëne arsimit të cilin e deshti dhe punoi deri ne ditën e fundit.